



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:182261
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05634911

C.A.P.nr.1065/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Besnik Bislimaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit „Sh., ShPK, me seli në Matlumë - Fusha e Pajtimit Kaçanik, me numër unik të biznesin: 810301151, kundër debitorit A. K., me adresë në fsh. D... Komuna e Kaçanik, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, 2021:182261 të datës 14.06.2023, me datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit A. K., me adresë në fsh. D.. Komuna e Kaçanik, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, 2021:182261 të datës 14.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar 2021:182261 të datës 14.06.2023, ka vendosur:

- I. REFUZOHET në tersi si i pa bazuar prapësimi i debitorit A.Ko., i ushtruar më datë: 14/07/2021, kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbartimit të përmbartuesit privat M. Sh. P.nr.230/2021 të datës: 29.06.2021 dhe mbetet në fuqi Urdhrit Përmbartimor P.nr.230/2021 të datës: 29/06/2021, lëshuar nga përmbartuesi privat M. S. Sh.-Fe..
- II. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi URDHËROHET që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në gjykatë në shumën prej: 500.00 euro.

III. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është parashtruar fare nga pala ankuese.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë debitori për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e debitorit dhe të shfuqizohet aktvendimi i ankimuar dhe të refuzohet në tërësi si i pa bazuar propozimin për përmbarim i kreditorit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), dhe nenit 194 e 208 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, ku pas kësaj gjeti se:

- Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Sh...., ShPK, me seli në M. - Fusha e Pajtitit Kaçanik, me numër unik të biznesin: 810301151, ka parashtruar propozim për përmbarim te Përmbaruesi Privat M. Sh., i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, kundër debitorit A. K., me adresë në fsh. D. Komuna e Kaçanik, në bazë të dokumentit të besueshëm, faturës me nr. 301 të datës 29.06.2021.

Përmbaruesi Privat Rr. M., e ka lejuar përmbarimin e propozuar me urdhër P.nr.230/2021 datë 29.06.2021, ndaj të cilit urdhër në afat ligjore ka paraqitur prapësim debitori me datë 14.07.2021, me propozim gjykatës që të shfuqizohet urdhri përmbarimor dhe të refuzohet propozimi për përmbarim i kreditorit. Përgjigje në prapësim me datë 26.07.2021, ka paraqitur kreditori me propozim gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar 2021:182261 të datës 14.06.2023, me të cilin ka vendosur që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, duke vendosur me shumë si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të Aktvendimit të atakuar ka arsyetuar se Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vendosi që të refuzojë prapësimin e debitorit, në tërësi si të pa bazuar, sepse debitori bazën për prapësim nuk e ka mbështetur me prova të duhura dhe ato prova nuk ia ka bashkangjitur prapësimit ashtu si është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së.

Më tej ka arsyetuar se: Po ashtu nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet e parapara në bazë të nenit 71 nga pika (1.1) deri tek pika (1.12) të LPP-së, prandaj gjykata nga arsyet e cekura më lart vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata vlerësoi se kreditori propozimin për përmbarrim, e ka bazuar në dokumentin e besueshëm – Faturë për furnizim me naftë nr.30-A/2020 e datës 01/08/2020 dhe në dokumentin e quajtur konfirmim të saldës dhe barazimit të kartelës së klientit e datës 15/08/2020 lëshuar nga „Shkëndija,, SHPK nënshkruar nga klienti Adem Kolshi. Po ashtu vlerëson se përmbarruesi privat me rastin e lëshimit të Urdhrit ka vepruar drejtë sepse është bazuar në faturën për furnizim me naftë nr.30-A/2020 e datës 01/08/2020 dhe kjo është konform neneve 21, 22, 27 dhe 29 par.1 pika 1.2 të LPP-s.

Më tej ka theksuar se: Gjykata e vlerësoi se kreditori ka vendosur lidhur me ankesën që i është bërë me shkrim nga ana e debitorit, ku kreditori e ka bashkangjitur Vendimin ndaj ankesës me shkrim të datës 19.07.2019 nga Komisioni për korrigjimin e Faturave. ku në pikën 3-Konkulidimi-Vendimi i Aprovuar, shihet se kjo kërkesë është refuzuar si e pa bazuar.

Më tej ka theksuar se: Gjykata i analizoi pretendimet e kreditorit të paraqitura në propozimin për përmbarrim dhe në përgjigje në prapësim dhe të njëjtave u ‘a fali besimin për shkak se ishin të drejta dhe të ligjshme për të gjitha arsyet e cekura më lartë.

Më tej ka theksuar se: Gjykata i ka analizuar edhe pretendimet e debitorit i cili ka kërkuar nga gjykata që prapësimin e debitorit ta miratoj dhe ta anuloj urdhrin dhe propozimi për përmbarrim të refuzohet. Këto pretendime gjykata si mori për bazë me rastin e vendosjes sepse debitori nuk e mohoi se ka pranuar naftë nga kreditori, nuk e mohoi se i ka borxh shumë të caktuar si në propozim dhe se borxhi nuk është parashkruar sipas dispozitave të LMD-së kjo për shkak se si shihet në faturë dhe konfirmim të barazimit me klientin data e lëshimit të dokumentit është data 15/08/2020 ndërsa propozimi është paraqitur më datë 29/06/2021 me çka është brenda afatit si është e paraparë në nenin 353 par 1 të LMD-s.

Gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka bazuar në nenin 29 par. 1 pika 1.3 lidhur me nenin 77 dhe 5 të LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i kjashtë, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimor se aktvendimi i gjykatës së shkallë së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i Aktvendimit është i kuptueshëm, i kjashtë dhe arsyetimi i Aktvendimit përmban të gjitha faktet vendimtare, dhe arsyet pse është vendosë si në dispozitiv të Aktvendimit e po ashtu aktvendimi i ankimuar, nga gjykata e shkallës së parë del të jetë marrë pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me mënyrën e vendosjes, të cilat kanë mbështetje në shkresat e lëndës dhe në ligj.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimi ankimor i debitorit se është bërë zbatim i gabuar i të drejtës materiale është pretendim i pabazuar dhe i njëjti nuk përbën bazë për anulimin e aktvendimit të atakuar, pala debitorë me ankesën e paraqitur nuk ka ofruar asnjë arsye për të mbështetur pretendimet e tij ankimore se kemi zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa Gjykata gjithashtu duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare konstaton se aktvendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, i mbështetur në dispozita ligjore. Në nenin 21 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, ndër të tjera thuhet se: “ *Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues dhe dokumentit të besueshëm...* ”, ndërsa në nenin 29 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, ndër të tjera thuhet se: “ *Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. faturat ...* ”. andaj, dhe pretendimet e debitorit në lidhje me dokumentin e basueshëm janë të pa bazuara pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se debitori edhe për kundër mos pranimit të faturës, i njëjti ka pranuar në tërësi borxhin që rrjedhë nga fatura dhe si të tillë tani më nuk paraqet relevancë fakti se a është nënshkruar fatura nga debitori apo jo, pasi që i njëjti me nënshkrimin e konfirmimit i saldës dhe barazimi i kartelës së klientit e datës 15.08.2020, ka konfirmuar se e ka papranuar edhe faturën e cekur si më lartë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se pretendimet e debitorit në lidhje me parashkrimin e borxhit janë të pabazuara për faktin se debitori me konfirmimin i saldës dhe barazimi i kartelës së klientit e datës 15.08.2020 e nënshkruar nga palët ndërfaqëse e ka pranuar borxhin në lartësi prej 3,045.45 euro, sipas nenit Neni 368 1 të LMD-së, i cili parasheh që “ Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ndërsa në paragrafin 2 të po të njëjtit nen është paraparë që “Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”. Andaj, në rastin konkret parashkrimi është ndërprerë pasi që debitori ka pranuar borxhin dhe njëkohësisht ka pranuar edhe detyrimin që kishte ndaj kreditorit dhe si i tillë të gjitha pretendimet e debitorit në lidhje me borxhin janë të pa bazuara dhe si të tilla nuk janë marrë për bazë nga Gjykata e Apelit.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktvendimi atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbare, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se “Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, e lidhur me nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbare, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr. 1065/2023 datë 29.04.2024

Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v